




Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME 2025

MONITORIMI I SHKELJEVE GJATË FUSHATËS
ZGJEDHORE NË MEDIAT SOCIALE

PRISHTINË, SHKURT 2025



ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME 2025

MONITORIMI I SHKELJEVE GJATË FUSHATËS
ZGJEDHORE NË MEDIAT SOCIALE



Përgatitur nga: Demokracia në Veprim (DnV)

Dizajn: ENVINION

Të drejtat e autorit ©2025. Demokracia në Veprim (DnV).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pjesëve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të DnV.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	8
Hyrje	9
Metodologjia	10
Gjetjet kryesore	12
Të përgjithshme.	12
Partitë politike dhe kandidatët.	20
Shkeljet me bazë gjinore.	26
Rekomandime	29
Shtojca 1: Fjalorth i shprehjeve kryesore	30

Rrjetet sociale në të cilat janë bërë më së shumti shkelje

91.8% Facebook

4.6% TikTok

2.6% Instagram

1% Youtube

Natyra e shkeljeve të raportuara

75.1% Gjuhë e urrejtjes

1.9% Dezinformata

16.4% Gjuhë shpifëse/
përçmuese

0.9% Meme

2.7% Keqinformim

0.5% Informata jashtë
kontekstit

2.5% Të tjera



GJETJET KRYESORE

Partitë politike me më së shumti shkelje

43.2%	AAK-NISMA
18.9%	VV
14.8%	LDK
11.8%	PDK
10.7%	Koalicioni për Familjen
0.6%	Lista Serbe

Partitë politike më të shënjestruara

81.8%	VV	0.1%	Koalicioni për Familjen
5.6%	PDK	0.1%	Lista Serbe
4.2%	AAK-NISMA	4.1%	Tjera
4.1%	LDK		

Lloji i shkelësve së supozuar

80.6%	Palë e tretë
11.4%	Kandidat individual
7.8%	Përkrahës i partisë politike/kandidatit
0.3%	Parti politike

878

SHKELJE



Njësia e monitorimit ka raportuar gjithsej 878 shkelje të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 9 shkurt 2025.

Përmbledhje ekzekutive

Fushata zgjedhore në mediat sociale është karakterizuar nga një klimë e ashpër dhe jo konstruktive, ku sulmet personale dhe propaganda kanë zënë vendin e debatit demokratik. Kjo qasje ka ndikime afatgjata në perceptimin e qytetarëve për procesin zgjedhor dhe besimin e tyre në institucionet demokratike. Për të ardhmen, është e nevojshme një qasje më e rregulluar dhe më e mbikëqyrur e komunikimit politik në platformat digjitale, si dhe një angazhim më i madh nga institucionet për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe keqinformimin në fushatat zgjedhore.

Krahas përpjekjeve për të fituar mbështetje elektorale, një pjesë e madhe e fushatës është fokusuar në sulme ndaj kundërshtarëve politikë, duke krijuar një mjedis të ashpër dhe konfrontues. Subjektet politike nuk janë vetëm viktimë të sulmeve, por edhe aktorë aktivë në përhapjen e narrativeve konfrontuese dhe shkeljeve të etikës zgjedhore. Me një përqindje të konsiderueshme të shkeljeve të regjistruara, duket se një pjesë e rëndësishme e strategjive zgjedhore është fokusuar në diskreditimin e kundërshtarëve, më shumë sesa në promovimin e programeve politike dhe ideve konstruktive.

Megjithatë, pjesa më e madhe e shkeljeve zgjedhore nuk është kryer drejtpërdrejt nga subjektet politike apo kandidatët, por nga akterë të jashtëm, si palët e treta dhe përkrahësit e ndryshëm. Akterët politikë mund të jenë duke përdorur rrjete joformale për të shmangur përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për përmbajtjet problematike. Dominimi i shkeljeve nga palët e treta të lidhura me VV-në tregon një prani më të fuqishme të aktivizmit digjital në favor të këtij subjekti politik, por gjithashtu ngre shqetësime mbi mënyrën se si po zhvillohet debati politik në hapësirën digjitale. Kjo situatë vë në pah nevojën për rregullime më të forta dhe moderim të përmbajtjeve digjitale gjatë fushatave zgjedhore, për të garantuar një proces zgjedhor më të drejtë dhe të balancuar.

Është evidente se fushatat negative dhe sulmet në rrjetet sociale kanë qenë një pjesë e rëndësishme e strategjive

politike gjatë fushatës zgjedhore. Fakti që kandidatët individualë kanë qenë më të sulmuarit, veçanërisht ata të VV-së, tregon një fokus të madh në diskreditimin e figurave të caktuara politike, më shumë sesa të subjekteve politike në tërësi. Ky trend ngre shqetësime mbi cilësinë e debatit politik në hapësirat digjitale dhe nevojën për masa më të forta për të mbrojtur kandidatët nga fushatat e organizuara të dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes. Po ashtu, nënvizon rolin e madh që luajnë rrjetet sociale në formësimin e perceptimit të votuesve, duke krijuar një klimë politike të tensionuar dhe shpeshherë të polarizuar.

Fushata u karakterizua nga një klimë e polarizuar, me përdorim të gjerë të retorikës konfrontuese dhe strategjive të keqinformimit. Në këtë kontekst, Facebook-u vazhdon të jetë platforma dominuese, duke u shndërruar në mjetin kryesor për komunikimin politik dhe, në të njëjtën kohë, për përhapjen e përmbajtjeve problematike. Megjithatë, rritja e ndikimit të platformave si TikTok dhe Instagram sugjeron një ndryshim të qasjes, veçanërisht për tërheqjen e votuesve të rinj përmes formateve audiovizuale më të shkurtra dhe më angazhuese. Edukimi medial, mekanizmat e mbikëqyrjes dhe bashkëpunimi mes platformave sociale dhe institucioneve zgjedhore janë thelbësore për të siguruar që debatet politike të zhvillohen në një mjedis më etik dhe demokratik. Sfidë kryesore mbetet balancimi mes lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së proceseve zgjedhore nga manipulimi dhe dezinformimi.

Gjithashtu, gratë në politikë përballen me nivele të larta të gjuhës denigruese dhe komenteve fyese në rrjetet sociale, shpesh duke u sulmuar jo për politikën e tyre, por për aspekte personale dhe stereotipe gjinore. Përdorimi i gjuhës ofenduese si mjet për t'i diskredituar dhe dekurajuar gratë nga angazhimi politik tregon një problem të thellë shoqëror, i cili kërkon reagim të fortë institucional dhe ndërgjegjësim publik. Vetëm përmes denoncimit të këtyre praktikave dhe krijimit të një hapësire më të sigurt e të barabartë për gratë në politikë, mund të arrihet një diskurs politik më i shëndetshëm dhe gjithëpërfshirës.

Hyrje

Zhvillimi i fushatave zgjedhore ka pësuar një transformim të madh në dekadën e fundit, me rrjetet sociale që tashmë janë shndërruar në arenën kryesore të komunikimit politik. Zgjedhjet e përgjithshme të 9 shkurtit 2025 në Kosovë e pasqyruan këtë prirje, ku debatet, promovimet dhe përplasjet politike u zhvendosën kryesisht në platforma si Facebook dhe TikTok. Ndërkohë që këto hapësira digjitale ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme për ndërveprim mes votuesve dhe kandidatëve, ato gjithashtu kanë krijuar sfida të reja, si përhapja e dezinformatave, përdorimi i gjuhës denigruese dhe rritja e polarizimit politik.

Ky raport synon të analizojë shkeljet e evidentuara gjatë fushatës zgjedhore në mediat sociale, duke përfshirë rastet e gjuhës së urrejtjes, shpifjeve, keqinformimit dhe strategjive të diskreditimit të kandidatëve. Monitorimi lidhur me mediat sociale është kryer nga organizata Demokracia për Zhvillim (D4D), si anëtare në kuadër të koalicionit Demokracia në Veprim (DnV), dhe përfshin një vëzhgim të detajuar mbi natyrën e shkeljeve, palët e përfshira dhe ndikimin e tyre në mjedisin zgjedhor. Bazuar në të dhëna të mbledhura nga mijëra postime dhe komente në rrjetet sociale, raporti ndriçon mënyrën se si aktorët politikë dhe mbështetësit e tyre përdorin platformat digjitale për të ndikuar në perceptimet e votuesve.

Një ndër aspektet më shqetësuese të kësaj fushate ishte gjuha e urrejtjes me bazë gjinore, e cila ishte e pranishme në një numër të madh postimesh dhe komentesh, veçanërisht ndaj kandidateve gra. Shumë prej tyre u përballën me sulme personale dhe ofendime që nuk kishin lidhje me programin apo qëndrimet e tyre politike, por me gjininë e tyre. Kjo tregon për sfidat e vazhdueshme që gratë në politikë hasin në një mjedis ende të dominuar nga stereotipet gjinore dhe paragjykimet.

Raporti përmban analiza të detajuara mbi partitë politike më të shënjestruara, llojin e shkeljeve më të zakonshme, si dhe ndikimin e tyre në atmosferën e përgjithshme të fushatës. Duke trajtuar këto çështje, synimi i raportit është që të krijojë një mjedis zgjedhor më të drejtë, etik dhe gjithëpërfshirës, ku debati politik të fokusohet më shumë në ide dhe më pak në sulme personale apo propagandë denigruese.

Metodologjia

Ky raport bazohet në një monitorim të detajuar të fushatës zgjedhore në rrjetet sociale, i realizuar nga një ekip prej pesë monitoruesve. Monitorimi u zhvillua gjatë gjithë periudhës së fushatës dhe kishte për qëllim evidencimin e shkeljeve, analizimin e narrativeve politike dhe vlerësimin e ndikimit të tyre në opinionin publik.

Fushëveprimi i monitorimit

Monitorimi është fokusuar në përmbajtjen e publikuar nga partitë politike dhe kandidatët e tyre në platformat kryesore të mediave sociale, duke përfshirë:

- Facebook – rrjeti më i përdorur për fushatë dhe diskutime politike
- TikTok – platformë me rritje të shpejtë, sidomos tek votuesit e rinj
- X (ish-Twitter) – përdorur kryesisht për diskutime politike dhe njoftime
- YouTube – kanal i rëndësishëm për fjalime, intervista dhe promovime
- Instagram – përdorur për postime vizuale dhe ndërveprime me votuesit

Monitoruesit kanë kontrolluar në baza të përditshme faqet dhe llogaritë zyrtare të partive politike dhe kandidatëve të tyre, duke regjistruar të gjitha postimet e bëra gjatë fushatës zgjedhore. Përveç analizimit të postimeve të subjekteve politike, është monitoruar edhe seksioni i komenteve për të identifikuar ndërveprimet e palëve të treta, përfshirë mbështetësit, kundërshtarët politikë dhe përdorues të tjerë të rrjeteve sociale që nuk ishin drejtpërdrejt të përfshirë në garën zgjedhore.

Përdorimi i platformës Pikasa për analizën e të dhënave

Për të siguruar një monitorim të thelluar dhe të standardizuar, ekipi ka përdorur platformën Pikasa, një mjet analitik që mundëson mbledhjen dhe përpunimin automatik të të dhënave nga rrjetet sociale. Pikasa ka ndihmuar në:

- Identifikimin dhe klasifikimin e komenteve negative, ofenduese ose me përmbajtje të papërshtatshme
- Matjen e ndërveprimeve (pëlqime, shpërndarje, komente) për të kuptuar përhapjen dhe ndikimin e përmbajtjeve politike
- Kategorizimin e shkeljeve sipas llojit (gjuhë e urrejtjes, shpifje, dezinformim, keqinformim, etj.)
- Evidencimin e kandidatëve dhe partive më të shënjestruara gjatë fushatës

Duke përdorur Pikasa, monitoruesit kanë analizuar gjithsej 86,576 artikuj të shpërndarë në Facebook, ku përfshihen postime të partive, kandidatëve dhe komentet nga përdoruesit e rrjeteve sociale.

Procesi i grumbullimit dhe analizës së të dhënave

Të gjitha të dhënat e mbledhura janë ruajtur dhe organizuar në një bazë të dhënash qendrore, duke përfshirë:

- Postimet dhe deklaratat zyrtare të partive politike dhe kandidatëve
- Komente dhe reagime nga palë të treta, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes, shpifjet dhe dezinformimin
- Llojin e shkeljeve të identifikuar gjatë monitorimit
- Platformën ku është bërë postimi apo komenti
- Ndikimin e përmbajtjeve, bazuar në numrin e ndërveprimeve të gjeneruara

Pas grumbullimit të të dhënave, ekipi i monitoruesve ka kryer një analizë të thelluar për të identifikuar modelet e komunikimit, subjektet më të shënjestruara dhe ndikimin e shkeljeve në atmosferën e përgjithshme të fushatës.

Kufizimet e studimit

Ky raport fokusohet vetëm në përmbajtjen të publikuar në rrjetet sociale dhe nuk përfshin komunikimet private apo të dhënat e disponueshme vetëm për administratorët e faqeve. Për shkak të dinamikës së shpejtë të rrjeteve sociale dhe mundësisë së fshirjes së disa postimeve apo komenteve, disa raste mund të mos jenë përfshirë në analizën përfundimtare. Megjithatë, kombinimi i monitorimit manual nga ekipi i DnV dhe përdorimi i Pikasa sigurojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi natyrën dhe shtrirjen e shkeljeve gjatë fushatës zgjedhore.


Gjetjet kryesore

Të përgjithshme

Njësia e monitorimit ka raportuar gjithsej 878 shkelje të cilat kanë ndodhur gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 9 shkurt 2025. Në këto zg-

jedhje morën pjesë gjithsej 28 subjekte politike, të cilat përfshinin 20 parti politike, pesë koalicione, dy iniciativa qytetare dhe një kandidat të pavarur. Këto subjekte konsistojnë në një total prej 1,280 kandidatësh për deputetë. Fushata zyrtare zgjedhore nisi me 11 janar dhe zgjati deri më 8 shkurt.


GRAFIKU 1 Shkeljet e raportuara sipas periudhës kur kanë ndodhur



Java e parë e fushatës zgjedhore (11 – 17 janar) ka shënuar një intensitet të ulët të shkeljeve të raportuara që përbëjnë 5% të totalit të shkeljeve të ndodhura gjatë gjithë fushatës zgjedhore. Fillimi qetë i fushatës është kryesisht për shkak të mobilizimit të ngadaltë të subjekteve politike dhe vëmendjes së ulët të publikut. Rritja e shkeljeve ka vazhduar gjatë javës së dytë (18-24 janar) duke shënuar 23% shkeljeve, për të kulmuar në javën e tretë (25-31 janar) me 43% të shkeljeve. Gjatë kësaj jave retorika e partive politike ishte ashpërsuar dhe sulmet e ndërsjella kanë qenë më të mëdha. Java

e katërt (1-8 shkurt), apo e përmbylljes së fushatës ka shënuar rënie me 29%. Në këto zgjedhje, për herë të parë nuk është aplikuar dita e heshtjes zgjedhore, si pasojë e ndryshimeve të ndodhur në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kjo mund të ketë ndikuar në dinamikën e fushatës, duke lejuar fushatë të pandërprerë deri në ditën e zgjedhjeve.


GRAFIKU 2 Proportioni i shkeljeve të raportuar sipas llojit të shkeljes



Dy të tretat e shkeljeve të raportuara kishin të bënin me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, e cila përbënte shumicën dërrmuese të rasteve (75.1%). Kjo është një tendencë shqetësuese e fushatës e cili ishte fokusuar në sulme verbale dhe polarizim. Përveç gjuhës së urrejtjes, një pjesë e konsiderueshme e shkeljeve lidhej me përdorimin e gjuhës shpifëse dhe përçmuese (16.4%), që tregon për një klimë të ashpër komunikimi midis akterëve politikë. Përhapja e keqinformimit (2.7%) dhe dezinformimit (1.9%) tregon gjithashtu një prirje për manipulim të opinionit publik, me synimin për të ndikuar në perceptimet e votuesve. Një fenomen interesant, megjithëse më pak i pranishëm, ishte përdorimi

i memeve (0.9%) dhe informacionit jashtë kontekstit (0.5%) si mjete për të çoroditur ose për të përçarur mesazhe të shtrembëruara. Këto shifra tregojnë se edhe format alternative të komunikimit politik janë përdorur për të ndikuar në elektorat në mënyra jo të drejtpërdrejta. Përveç kategorive kryesore, është identifikuar edhe një përqindje e vogël e shkeljeve të tjera (2.5%) gjatë monitorimit, të cilat i vlerësojmë si joetike. Në përgjithësi, këto të dhëna pasqyrojnë një fushatë elektorale të tensionuar dhe të dominuar nga narrativet konfrontuese, në të cilën propaganda dhe sulmet personale ishin më të pranishme se debati i hapur dhe konstruktiv.

GRAFIKU 3 Shkeljet e raportuara sipas periudhës kur kanë ndodhur




Të dhënat e monitorimit tregojnë se shkeljet më të shpeshta gjatë fushatës zgjedhore janë kryer nga palët e treta, të cilat përfaqësojnë 80.6% të rasteve të raportuara. Kjo kategori përfshin aktorë jashtë vetë kandidatëve dhe partive politike, si organizata joformale, individë me ndikim në rrjetet sociale, faqe anonime dhe grupime të ndryshme që mbështesin ose sulmojnë akterë të caktuar politikë. Ky rezultat tregon se një pjesë e madhe e retorikës së ashpër dhe shkeljeve ligjore nuk ka ardhur drejtpërdrejt nga vetë partitë politike apo kandidatët, por nga mbështetësit e tyre të jashtëm.

Në vend të dytë për nga numri i shkeljeve të raportuara renditen kandidatët individualë me 11.4%, duke treguar se një përqindje e vogël e shkeljeve është kryer drejtpërdrejt nga ata që garonin në zgjedhje. Ndërkohë, përkrahësit e partive politike apo kandidatëve përbëjnë 7.6% të rasteve, duke reflektuar një prani më të vogël të shkeljeve nga aktivistët dhe simpatizantët politikë krahasuar me palët e treta.

Ajo që bie më së shumti në sy është fakti se vetë partitë politike kanë përqindjen më të ulët të shkeljeve të raportuara, me vetëm 0.3%, çka sugjeron një kujdes më të madh nga ana e tyre për të mos u përfshirë dre-

GRAFIKU 4 Palët më të shenjëstra



jtpërdrejt në akte të dënueshme, ndoshta për shkak të pasojave ligjore dhe dëmit në imazhin publik. Nga analiza e mëtejshme e palëve të treta, rezulton se shumica dërrmuese e shkeljeve nga kjo kategori janë bërë nga mbështetësit e Vetëvendosjes (VV), me 82% të rasteve. Kjo tregon një angazhim të fortë nga rrjete joformale të mbështetësve të kësaj partie në diskursin politik online, shpesh duke përdorur gjuhë të ashpër apo taktika agresive kundër kundërshtarëve politikë.



Në krahasim, mbështetësit e PDK-së kanë kontribuar me 7.1% të shkeljeve, ndërsa përkrahësit e AAK-NISMA-s përbëjnë 5.4% të rasteve. LDK-ja ka pasur një përfshirje edhe më të ulët, me 4% të shkeljeve, ndërsa mbështetësit e partive të tjera kanë kontribuar vetëm 1.6% në këtë kategori.



Të dhënat e monitorimit tregojnë se kandidatët individualë të partive politike kanë qenë më së shumti cak i sulmeve në rrjetet sociale, duke përbërë 86% të të gjitha rasteve të raportuara. Ky rezultat nënvizon se sulmet dhe fushatat negative kanë qenë të fokusuara kryesisht në figura të veçanta politike, më shumë sesa në partitë politike si entitete kolektive. Në vend të dytë si

objektiv i sulmeve janë vetë partitë politike, me 10.6% të rasteve, duke treguar se edhe platformat politike kanë qenë të ekspozuara ndaj gjuhës së ashpër dhe propagandës kundërshtarë. Palët e treta – të cilat përfshijnë individë ose grupe që nuk janë drejtpërdrejt pjesë e garës zgjedhore – kanë qenë cak i sulmeve në vetëm 2.1% të rasteve, ndërsa përkrahësit e partive politike apo kandidatëve kanë pasur ekspozimin më të ulët ndaj sulmeve, me vetëm 0.6% të rasteve.

Nga një analizë më e thellë e sulmeve ndaj kandidatëve individualë, del se shumica dërrmuese e tyre kanë qenë të drejtuara ndaj kandidatëve të VV-së, të cilët kanë qenë shënjestër e 78.7% të sulmeve. Kjo sugjeron se kandidatët e kësaj partie kanë qenë më të ekspozuar ndaj kritikave, fushatave negative apo dezinformimit, ndoshta për shkak të rolit të tyre dominues në fushatë apo pozicionit të tyre në skenën politike. Në vend të dytë për nga numri i sulmeve ndaj kandidatëve vijnë ata të AAK-NISMA-së, me 9.8% të rasteve, pasuar nga kandidatët e PDK-së (5.9%) dhe ata të LDK-së (5.1%). Ndërkohë, kandidatët e partive të tjera kanë qenë shënjestër në vetëm 0.4% të rasteve, duke treguar një ndikim të vogël në debatin negativ.

GRAFIKU 5 Shkelësit e raportuar kundrejt partive politike të shënjestruara





Fushata zgjedhore e këtij viti ka qenë e shënuar nga një nivel i lartë i tensioneve dhe shkeljeve të raportuara, të cilat kanë pasur ndikim të ndjeshëm në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm tregojnë dy aspekte kryesore: partitë politike që janë shënjestruar më së shumti nga shkeljet dhe ato që kanë kryer numrin më të madh të shkeljeve. Lëvizja Vetëvendosje (VV) ka qenë partia më e shënjestruar gjatë fushatës, duke përbërë 81.8% të rasteve të raportuara. Ky numër tregon një përqendrim të madh të sulmeve kundër kësaj partie, duke e bërë atë subjektin kryesor të përplasjeve politike në diskursin publik. Partitë tjera kanë qenë më pak objekt i sulmeve, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e cila ka përjetuar 5.6% të rasteve të raportuara, koalicioni AAK-NISMA (4.2%) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka pasur (4.1%). Subjektet e tjera kanë qenë relativisht më pak të ekspozuara ndaj sulmeve gjatë fushatës zgjed-

hore. Koalicioni për Familjen (0.1%) dhe Lista Serbe (0.1%) kanë qenë pothuajse të paprekura nga shkeljet e raportuara, duke treguar një interes më të ulët për sulme ndaj tyre nga kundërshtarët politikë.

Subjekti politik AAK-NISMA renditet i pari me më së shumti shkelje të raportuara, duke qenë përgjegjëse për 43.2% të tyre. Pas saj, VV zë vendin e dytë me 18.9%, pavarësisht se ka qenë subjekti më i shënjestruar nga sulmet gjatë fushatës. LDK renditet e treta me 14.8% të shkeljeve, pasuar nga PDK (11.8%) dhe Koalicioni për Familjen (10.7%) kanë pasur gjithashtu një pjesëmarrje të lartë në shkeljet e raportuara. Ndërkohë, Lista Serbe ka pasur ndikimin më të ulët në këtë aspekt, me vetëm 0.6% të rasteve të shkeljeve të regjistruara.

Fushata zgjedhore e këtij viti ka reflektuar një zhvendosje të theksuar drejt mediave sociale si hapësira

GRAFIKU 6 Proporcioni i shkeljeve sipas rrjeteve sociale




kryesore e komunikimit politik, debatit publik dhe, për fat të keq, përhapjes së shkeljeve. Për të kuptuar më mirë këtë fenomen, ekipi monitorues kreu një monitorim të detajuar në disa prej platformave më të përdorura, duke përfshirë Facebook, TikTok, YouTube, X (ish-Twitter) dhe Instagram. Rezultatet e monitorimit treguan qartë se Facebook-u është platforma ku ndodhi pjesa më e madhe e shkeljeve të raportuara, me 91.8% të tyre. Ky numër dëshmon se kjo platformë vazhdon të jetë mjeti kryesor për debatet politike, por edhe për përhapjen e retorikës së ashpër, dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes. Duke qenë rrjeti social më i përdorur në Kosovë, Facebook-u ka ofruar një terren të përshtatshëm për shpërndarjen e përmbajtjeve që shpesh kanë kaluar kufijtë e komunikimit etik dhe ligjor.

Në vend të dytë, por me një diferencë të ndjeshme, renditet TikTok-u me 4.6% të shkeljeve të raportuara. Ky rrjet, i cili është veçanërisht i popullarizuar te të rinjtë, është shfrytëzuar për përhapjen e mesazheve politike në formate më të shkurtra dhe më tërheqëse vizuelisht. Ndërkohë, Instagram-i dhe YouTube-i kanë pasur një ndikim edhe më të kufizuar, me përkatësisht 2.6% dhe 1% të shkeljeve të raportuara. Këto platforma, ndonëse të rëndësishme për shpërndarjen e materialeve audio-vizuale, kanë një natyrë më të strukturuar, duke e bërë më të vështirë përmbajtjen e drejtpërdrejtë problematike të përhapet në të njëjtën shkallë si në Facebook.

Ndërkohë që rrjetet e tjera sociale po fitojnë terren, veçanërisht tek të rinjtë, Facebook-u mbetet epiqendra e betejës politike online – një arenë ku debati demokratik dhe keqpërdorimi i hapësirës digjitale shpesh ecin paralelisht.

GRAFIKU 7 Lloji i përmbajtjes përmes së cilët janë postuar shkeljet



Analiza e përmbajtjes së shkeljeve të raportuara tregon se komentet në rrjetet sociale janë forma dominuese e shkeljeve, duke përfaqësuar 80.1% të rasteve. Kjo tregon se përdoruesit janë më të prirë të përdorin seksionin e komenteve për të shprehur gjuhën e urrejtjes, shpifjet ose përhapjen e dezinformatave, shpesh duke reaguar ndaj postimeve të politikanëve, mediave apo faqeve të ndryshme publike. Përveç komenteve, një pjesë e konsiderueshme e shkeljeve është përhapur përmes videove (8%), të cilat janë përdorur si mjete efektive për të amplifikuar mesazhe politike apo për të sulmuar kundërshtarët. Në këtë kategori përfshihen edhe video të montuara me qëllim manipulimi apo narrativet që përdorin elemente vizuale për të rritur ndikimin e tyre.

Postimet e shoqëruara me foto (6.8%) dhe postimet e thjeshta të shkruara (5%) gjithashtu kanë kontribuar në përhapjen e përmbajtjes problematike, por në një shkallë më të vogël krahasuar me komentet. Këto postime shpesh përdoren për të ndërtuar narrativa të qëndrueshme ose për të formuar opinionin publik mbi tema të ndjeshme politike. Në anën tjetër, 'story'-t përbëjnë vetëm 0.1% të shkeljeve, duke treguar se kjo formë e përkohshme e përmbajtjes nuk ka qenë një kanal i përdorur gjerësisht për shkelje gjatë fushatës zgjedhore.

Partitë politike dhe kandidatët

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në mesin e kriterëve për regjistrim të partive politike kërkon edhe nënshkrimin e deklaratës nga kryetari i partisë për të respektuar dhe për t'iu përmbajtur Kodit të Mirësjelljes së Partive Politike.¹ I njëjti kriter vlen edhe për certifikim për të marrë pjesë në zgjedhje. Ndërsa kapitulli V i ligjit i dedikohet Kodit të Mirësjelljes, që ka për qëllim "krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit".²

Kodi Zgjedhor përcakton qartë përgjegjësitë dhe kufizimet për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre gjatë fushatës zgjedhore. Të gjitha

partitë politike dhe individët e përfshirë në procesin zgjedhor kanë detyrimin të respektojnë dispozitat e këtij Kodi, ndërsa Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP) ka autoritetin për të shqyrtuar dhe sanksionuar shkeljet e mundshme. Subjektet politike janë të obliguara të informojnë anëtarët dhe mbështetësit e tyre mbi normat e sjelljes dhe të ndërmarrin masa për të parandaluar shkeljet. Përdorimi i gjuhës së urrejtjes, publikimi i materialeve nxitëse apo dezinformuese që mund të shkaktojnë tensione dhe dhunë, konsiderohet shkelje serioze dhe është subjekt i masave ndëshkuese nga autoritetet përkatëse.

Kjo pjesë e raportit paraqet vetëm disa nga shkeljet ilustruese të përzgjedhura të përdorura nga liderë, kandidatë apo anëtarë të partive të ndryshme politike gjatë fushatës.

Lëvizja Vetëvendosje


Në një tubim elektorale të VV-së në Komunën e Vushtrrisë, që është shpërndarë me video në faqen zyrtare të këtij subjekti politik, kandidati për deputet Xhelal Sveçla, në fjalën e tij i quan disa përfaqësues të partive opozitare si

disa bërlloga të partive të vjetra".



¹ Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 13, paragrafi 4.5, i qasshëm në Gazetën Zyrtare: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=77074>

² Po aty, Kapitulli V.



Kandidati tjetër për deputet, Hajrullah Çeko, në postim në profilin e tij në Facebook, duke kritikuar Lidhjen Demokratike të Kosovës, i deformon emrin në terma pezhorativ si

Lidhja demokratike”.



Dimal Basha, i cili ishte në listën e kandidatëve për deputet të VV-së, në një postim në Facebook ka ofenduar gazetarin Berat Buzhala, duke e quajtur


copë m**”.**

I njëjti ofendim është përsëritur edhe në komente nga përdorues të tjerë.

Blerim Gashani, i cili ishte pjesë e listës së VV-së nga partia Guxo, i ka quajtur

Stanishiqët”

ata që, sipas tij, po e mbrojnë LDK-në, ndonëse dikur e sulmonin. Termi “stanishiqët” i referohet Jovica Stanishiqit, ish-shefit të Sigurimit Sekret serb, të cilin Albin Kurti e ka lidhur më herët me Baton Haxhiun.



Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

Kandidati për deputet i PDK-së, Ardian Kastrati, në një postim të tij në Facebook, e ka quajtur kryetarin e VV-së, Albin Kurtin,

“babën ideologjik komunist”.

i cili duhet të “shporrur” nga pushteti pasi në pretendimin e tij e shkatërroi Kosovën. Këtë postim e ka shoqëruar me një foto të tij që përmban numrin në listën e kandidatëve për deputet, dhe me thirrjen për ta votuar.



Gjithashtu, Kastrati, në një video të postuar në profilin e tij në Facebook, u ka bërë thirrje simpatizantëve të VV-së që të mos përdorin gjuhë ofenduese. Ai u ka kërkuar atyre “të mos e bëjnë


“gojën WC”,


por të përdorin vetëm argumentin”.

Kastrati, i cili ka qenë aktiv në përdorimin e ofendimeve ndaj Albin Kurtit, në një postim tjetër në Facebook ka shpërndarë një fragment nga paraqitja e tij në një debat televiziv në TëVë1. Në këtë postim, ai ka konkluduar se Albin Kurti “po i frikësohet burgut” dhe se kjo është arsyeja pse “po bën

“fjalime patetike prej budallai”

gjatë fushatës zgjedhore.





Hisen Berisha, kandidati i PDK-së për deputet, ka shpërndarë një video të mëhershme nga fjalimi i tij në një seancë të Kuvendit të Kosovës. Në këtë postim, ai ka deklaruar se sulmi në kanalën e Ibër Lepencit është një vepër e koordinuar ndërmjet Kryeministrit Albin Kurti dhe Presidentit të Serbisë, Aleksandar Vučić.



Betim Gjoshi, kandidati për deputet i PDK-së, në një paraqitje të drejtpërdrejtë në Kanal 10, që është shpërndarë në YouTube, e quan analistin në studio si "qorri i fundit", duke i thënë "ti Blerim je mbet".

“qorri i fundit”

që je duke u munduar me mbrojt Albin Kurtin,...po them në kuptim mendoj, jo në të pamurit”.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)



Kandidati për deputet i LDK-së, Berat Rukiqi, në një postim në Facebook, duke u përgjigjur në gjuhën fyese dhe kërcënuese që kishte përdorur Kryeministri Kurti ndaj LDK-së, ka thënë për VV-në

“se juve po ju ndihet vetëm piskama në foltore”.

Gjuhë ofenduese është përdorur edhe në komente nga palë të treta duke i quajtur VV-në si “rrugaq”.


Ndërsa, kandidati Ardian Olluri nga LDK, në një postim në Facebook ka thënë se Albin Kurti

“përdhosi me të gjitha institucionet”

e saj deri sa erdhi në pushtet”.



Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - NISMA



Zafir Berisha, i cili ishte pjesë e listës së deputetëve të AAK-NISMA, në një postim në Facebook ka quajtur VV-në “infantilët e regjimit”, duke përdorur gjuhë përçmuese. Ndërsa, në një tjetër postim, duke kritikuar takimet e ministres Rizvanolli në Davos, ai ka shkruar se

këta o kanë rrëshqit, o janë bërë për te Burdushi³,

diçka nuk janë në terezi”.

Koalicioni për Familjen



Kandidatë për deputet i Koalicioni për Familjen, Petrit Mulaku, në një postim në Facebook, ka përdorur një gjuhë përjashtuese ndaj komunitetit LGBTQ+, duke e paraqitur ekzistencën dhe të drejtat e këtij komuniteti si një

rrezik”

për shtetin dhe identitetin kombëtar.

3 Burdushi është nofka e Hysri Peqanit, një person i njohur në Kosovë si “mjek popullor” ose “fallxhor”. Ai pretendonte se kishte aftësi për të shëruar sëmundje dhe për të parashikuar të ardhmen, por ishte i përfshirë në disa raste gjyqësore dhe u arrestua për mashtrim dhe veprimtari të paligjshme. Emri i tij shpesh përdoret në mënyrë ironike ose tallëse për të nënkuptuar dikë që beson në teori konspirative ose që nuk është i besueshëm.



Kandidati tjetër nga ky koalicion, Asdren Bytyqi, duke kundërshtuar vendimin e PZAP për gjobitje të këtij subjekti politik, në një postim në Facebook ka përdorur gjuhë përçmuese ndaj komunitetit LGBTQ+, duke shkruar se

“i themi jo martesës burrë me burrë e gru me gru”,

...dhe se

“na detyrojmë të heshtim përballë degjenerimit”.

Initiativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)



Kandidati për deputet në listën e IRDK-së, Fridon Lala, ka përdorur gjuhë përçmuese ndaj Kryetarit të PLE-së, Veton Berisha, duke e quajtur


“pazargji”.

Në një postim në Facebook, ai ka shkruar se

“Po e kuptoj shqetësimin e ish-deputetit pazargji për vizitën e KM”.

Shkeljet me bazë gjinore

Shumë shoqëri ende i shohin rolet politike si kryesisht të burrave, duke paragjykuar gratë që synojnë pozita të larta. Në vend që të vlerësohet aftësia e tyre, shpesh u kërkohet të "qëndrojnë në profesionet tradicionale" si arti, mësimdhënia apo kujdesi familjar. Gratë gjykohen jo vetëm për vendimet politike, por edhe për pamjen, zërin, veshjen apo jetën personale. Burrat politikanë rrallëherë përballen me të njëjtin lloj sulmi personal. Gjuha denigruese dhe sulmet personale shpesh përdoren si strategji për t'i diskredituar gratë në politikë dhe për të krijuar një ambient ku ato ndihen të pasigurta ose të pavlera. Platformat si Facebook u japin mundësinë njerëzve të ofendojnë pa pasur përballje të drejtpërdrejtë, duke i bërë sulmet më të lehta dhe më të shpeshta.



Për të analizuar ambientin e fushatës në rrjetet sociale, DnV ka përdorur platformën "Pikasa", për të analizuar komentet për 61 gra kandidatë të cilat janë paraqitur në 86,576 artikuj të shpërndarë në Facebook. Katër gratë që kanë marrë më së shumti komente negative janë:


- 1 Fitore Pacolli - Dalipi: 1,426 komente
- 2 Albulena Haxhiu: 1,057 komente
- 3 Hykmete Bajrami: 931 komente
- 4 Doarsa R. Kica: 756 komente

Top 100 Women MP candidates

Total	Albulena Haxhiu	Fitore Pacolli - Dalipi	Hykmete Bajrami	Doarsa R. Kica
Articles:	679	76	282	95
Articles Engagements:	16,902	1,885	7,439	3,547
Social Posts:	152	184	156	161
Social Engagements:	41,997	5,718	49,389	14,193
Total Posts:	831	262	438	
Total Engagements:	58,899	58,983	76,828	
Facebook Fans:	0	24,888	35,203	30,714
Facebook Talking:	0	507	4,165	5,829
Youtube Subscribers:	0	0	0	0
Youtube Views:	0	0	0	0
Instagram Followers:	8,856	3,917	1,625	627
Instagram Following:	208	201	435	4

Nga krahasimi i numrit të artikujve ku përmenden top tre kandidatet gra me më së shumti gjuhë të urrejtjes, shohim se në total ndërveprime duke përfshirë artikuj dhe postime online, më së shumti ka **Hykmete Bajrami** me 76,827 komente, pastaj **Fitore Pacolli - Dalipi** me 58,983 komente, dhe **Albulena Haxhiu** me 58,899 komente.

Nga monitorimi i rasteve të postimeve të kandidateve gra për deputete dhe komentet negative që ato kanë marrë, shohim gjuhë denigruese nga palë të treta.




Kandidatja për deputete në listën e VV-së, Fitore Pacolli – Dalipi në një video të publikuar në profilin e saj në Facebook është përballur me gjuhë fyese në komente nga palë të treta, duke u quajtur

“rrugaqe”,

“hajdute”,

“e shkretë”.




Anëtarja tjetër e VV-së, Edona Llaloshi ka qenë cak i komenteve ofenduese në profilin e saj në Facebook. Duke qenë këngëtare me profesion, ofendimet më të shpeshta janë lidhur me këtë, duke e “sugjeruar” të vazhdojë karrierën në muzikë dhe të mos merret me politikë. Një komentues shkruan

“o lopo, futja muzikes se nuk je per politike”.

Komente të tjera ofenduese kanë qenë edhe

“ti qysh e hangre foren e hyne ne VV te dhane shume lek oj mashtruse”.



Kandidatja e VV-së, Arbërie Nagavci, në një video të postuar në profilin e saj në Facebook, ka pranuar komente negative. Në mesin e tyre, një faqe e quan

Ti je vetëm një analfabete e moderuar”.

Arbërie Nagavci është njëherësh ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Rekomandime

1 Për Institucionet Shtetërore dhe Rregullatore

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP):

- Forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe ndëshkimit për subjektet politike dhe kandidatët që përdorin gjuhë të urrejtjes dhe dezinformim në fushatë.
- Aplikimi i kategorive në bazën e të dhënave për shkeljet gjatë fushatave, publikimi i vendimeve në formate të editueshme dhe ndëshkimi i përsëritësve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ):

- Miratimi i udhëzimeve të qarta mbi sjelljen e subjekteve politike dhe kandidatëve në rrjetet sociale.

Agjencia për Informacion dhe Privatësi (AIP):

- Zhvillimi i një kornize ligjore për mbrojtjen e qytetarëve nga keqpërdorimi i të dhënave personale në fushatat zgjedhore.
- Rritja e bashkëpunimit me platformat sociale për të kufizuar përhapjen e dezinformatave dhe sulmeve të orkestruara.

2 Për subjektet politike dhe kandidatët

- Hartimi dhe zbatimi i një Kodi Etik për Fushatat Digjitale për të shmangur përdorimin e strategjive negative dhe propagandës.
- Organizimi i trajnimeve për kandidatët dhe ekipet e tyre mbi përdorimin etik të mediave sociale.
- Krijimi i një mekanizmi të brendshëm për raportimin dhe adresimin e shkeljeve nga mbështetësit e partive.

3 Për Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Mediat

- Zhvillimi i fushatave të edukimit medial për të informuar qytetarët mbi rreziqet e dezinformimit dhe ndikimin e propagandës në zgjedhje.
- Krijimi i platformave për verifikimin e fakteve, ku qytetarët mund të raportojnë dhe kontrollojnë informacionet e dyshimta gjatë fushatës.
- Organizimi i debateve publike për të promovuar një diskurs më konstruktiv dhe të informuar gjatë zgjedhjeve.

Shtojca 1:

Fjalorth i shprehjeve kryesore

Gjuha e urrejtjes	Fjalim ose shkrim abuziv ose kërcënues që shpreh paragjykim kategorik kundër një grupi të caktuar, veçanërisht në bazë të racës, gjinisë, fesë ose orientimit seksual
Dezinformim	Informacione të rreme të shpërndara qëllimisht dhe shpeshherë fshehtëzi (siç është nisja e thashethemeve) me qëllim që të ndikojë në opinionin publik ose të turbullojë të vërtetën
Keqinformim	Përhapja e informacionit të gabuar ose të pavërtetë, pavarësisht nëse është bërë me qëllim apo pa qëllim
Informacion jashtë kontekstit	Kur një pjesë e informacionit ose një deklaratë interpretohet, përdoret ose paraqitet në një mënyrë që nuk reflekton kuptimin e saj të plotë apo të saktë në kontekstin origjinal. Kjo mund të ndodhë qëllimisht ose pa dashje dhe shpesh çon në keqkuptime ose interpretime të gabuara.
Gjuhë shpifëse/përçmuese	Çdo lloj gjuhe, qoftë e shkruar apo e folur, që ka për qëllim të ulë, të dëmtojë reputacionin, ose të denigrojë një person, grup apo institucion.
Meme	Foto, video, etj. zbavitëse ose interesante, që përhapet gjerësisht në internet



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action